

RAPORTET E PROGRESIT TË BASHKIMIT EUROPIAN PËR SHQIPËRINË PËR VITET 2010 - 2014, KAPITULLI 25: KËRKIMI DHE SHKENCA

Progres Raporti 2014 për Shqipërinë

4.25. Kapitulli 25: Shkenca dhe Kërkimi

Ka pasur një rritje shumë të kufizuar të numrit të subjekteve pjesëmarrëse në thirrjet për propozime për kërkim, në sajë të Programit Kuadër të BE-së (FP7), me një shkallë të përgjithshme suksesi prej 14.4%, në krahasim me mesataren e BE-së prej 21.6%. Marrëveshja për pjesëmarrjen e Shqipërisë në programin e ri të BE-së “Horizon 2020” për kërkimin shkencor dhe inovacionin (përfshi vitet 2014-20) u nënshkrua në korrik 2014, duke mundësuar pjesëmarrjen retroaktive të subjekteve nga vendi që nga 1 janar 2014. Janë vënë në funksionim masat e nevojshme administrative për pjesëmarrjen, si emërimi i pikave kombëtare të kontaktit dhe përfaqësuesve në komisionet e programit.

Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit (AKTI) në përgjithësi nuk ka pasur mjetet e duhura për të qenë më aktive në nxitjen e bashkëpunimit për kërkimin shkencor dhe inovacionin, edhe pse ka organizuar seminare (workshops) teknike në përgatitjen e “Horizonti 2020”.

Për sa i përket integritimit në Hapësirën Evropiane të Kërkimit (ERA), nuk është ndërmarrë ndonjë veprim dhe niveli i investimit në kërkim është ende shumë i ulët (vlerësohet më pak se 0.4% si përqindje e PBB-së të Shqipërisë). Për shkak të mungesës së statistikave të besueshme është e vështirë të përcaktohet niveli i saktë i investimeve, në veçanti shpenzimet për kërkim nga sektori privat. Shqipëria ka emëruar një përfaqësues në Komitetin e Hapësirës Evropiane të Kërkimit.

Për sa i përket Unionit të Inovacionit, strategjia kombëtare për kërkimin shkencor dhe inovacionin 2016- 20 parashikon disa masa për të nxitur inovacionin, por duhet të miratohet së bashku me një plan veprimi për zbatimin. Shqipëria ka qenë aktive në bashkëpunimet në nivel rajonal dhe ka bashkë-nënshkruar Strategjinë K&Zh të Rajonit të Ballkanit Perëndimor për Inovacion, e miratuar në tetor 2013.

Përfundim

Shumë pak përparim është bërë në fushën e shkencës dhe kërkimit. Duhet bërë përpjekje të mëtejshme për rritjen e kapaciteteve dhe investimeve në kërkim për të siguruar integritimin në Hapësirën Evropiane të Kërkimit dhe për të kontribuar në Unionin e Inovacionit. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për pjesëmarrje të suksesshme në programin kuadër të BE-së për kërkimin, “Horizonti 2020. Në tërësi, përgatitjet nuk kanë avancuar mjaftueshëm.

Progres Raporti 2013 për Shqipërinë

4.25. Kapitulli 25: Shkenca dhe kërkimi

Për sa i përket **politikave të kërkimit dhe novacionit**, janë marrë disa masa për stimulimin e novacionit dhe për përforcimin e burimeve njerëzore. Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit (AKTI) ka shtuar përpjekjet për promovimin e pjesëmarrjes në programet e BE-së për kërkimin, por shkalla e suksesit në përgjithësi është ende shumë e ulët. Buxheti kombëtar për kërkim është rritur lehtë, por niveli i investimeve në kërkim dhe zhvillim teknologjik është ende shumë i ulët. Nevojiten më shumë burime financiare, sidomos për forcimin e kapaciteteve dhe modernizimin e infrastrukturës.

Për sa i përket pjesëmarrjes së Shqipërisë në **Programin e Shtatë Kuadër** të BE-së (FP7), AKTI ka rritur përpjekjet dhe mbështetjen për komunitetin shkencor, por niveli i pjesëmarrjes dhe shkalla e suksesit (13%) janë ende shumë të ulëta. Për shkak të shtrëngimeve buxhetore, pjesëmarrja e AKTI-t në eventet e BE-së për krijimin e rrjeteve ka pësuar rënie. AKTI është angazhuar në marrëveshje bashkëpunimi dypalëshe me Italinë, Greqinë, Malin e Zi, ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Slloveninë dhe Turqinë. Për herë të parë është organizuar dita e informimit në Tiranë për Qendrën e Përbashkët Kërkimore. AKTI ka filluar përgatitjet për pjesëmarrjen në programin kuadër të BE-së për kërkimin, "Horizon 2020".

Për sa i përket integritit në **Hapësirën Evropiane të Kërkimit** (ERA), janë marrë disa masa për të rritur kapitalin njerëzor, kryesisht duke rritur Fondin e Ekselencës dhe duke zgjeruar programin "Brain Gain" në bashkëpunim me UNDP-në. AKTI po realizon me sukses portalin Euraxess. Financimi i kërkimit shkencor për historinë dhe gjuhën shqiptare është njohur si çështje prioritare. Për shkak të mungesës së statistikave të besueshme, është e vështirë të përcaktohet niveli i investimeve si përqindje e PBB-së, por vlerësohet rreth 0.35%. Kontributi i sektorit privat dhe NVM-ve në kërkim dhe zhvillim teknologjik në veçanti, është shumë e kufizuar. Për sa i përket Unionit të Novacionit, Qendra Shqiptare e Biznesit dhe Inovacionit në Agjencinë Shqiptare për Investime dhe Zhvillim (AIDA) vazhdoi të nxitë novacionin nga sipërmarrësit, duke rritur auditet e teknologjisë dhe masat me fokus NVM-të.

Përfundim

Shumë pak përparim është bërë në fushën e shkencës dhe kërkimit. Duhet bërë përpjekje të mëtejshme dhe investime në kërkim për të siguruar integritimin në Zonën Evropiane të Kërkimit dhe për të kontribuar në Unionin e Inovacionit. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për pjesëmarrje të suksesshme në programin kuadër të BE-së për kërkimin, "Horizon 2020". Në tërësi, përgatitjet nuk kanë avancuar mjaftueshëm.

Progres Raporti 2012 për Shqipërinë

4.25. Kapitulli 25 Shkenca dhe Kërkimi

Ka patur progres te limituar ne politikat kërkimore dhe inovative. Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit (AKTI) ka forcuar kapacitetet e saj administrative dhe ka vazhduar përpjekjet për te promovuar bashkëpunimin sipas Programit te Shtate Kuadër te Bashkimit European, nëpërmjet faqes se saj zyrtare dhe aktiviteteve për rritjen e ndërgjegjësimit. Asnjë progres nuk është bere ne drejtim te integritimit ne Zonën Europiane te Kërkimit dhe kontributi ne Unionin Inovativ ka qene i limituar. Niveli kombëtar i investimeve ne kërkim dhe zhvillim teknologjik është akoma shume i ulet dhe nuk ka pasur rritje qe prej vitit 2010, pavarësisht objektivave-kufijve te përcaktuar ne Strategjinë Kombëtare te Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit 2009-2015.

Ne lidhje me pjesëmarrjen e Shqipërisë ne Programin e Shtate Kuadër te Bashkimit European (FP7), numri i aplikimeve është rritur por numri i projekteve te suksesshme qe kane marre financim është akoma shume i ulet. Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit ka rritur përpjekjet e saj ne promovimin dhe organizimin e sesioneve trajnuese duke marre pjese ne disa evente te rrjeteve Evropiane dhe duke ndjekur ne mënyre aktive vazhdimësinë e Projektit WBC.INCO.Net, ne kuadër te FP7.AKTI ka nënshkruar Marrëveshje te Bashkëpunimit Dy-palesh me Italinë, Greqinë, Malin e Zi, Ish Republikën Jugosllave te Maqedonisë, Sllovenin dhe Turqinë.

Persë i përket integritimit ne Zonën Europiane te Kërkimit (ERA), ka pasur pak progres ne implementimin e Strategjisë Kombëtare për Shkence, Teknologji dhe Inovacion. Disa masa janë marre për te forcuar burimet njerëzore, te tilla si rritja e Fondit te Ekselencës për te nxitur mobilitetin e jashtëm si edhe ngritja e Portalit Kombëtar Euraxess nga AKTI si dhe fillimi i ndërtimit te rrjetit. Nuk ka përparim ne krijimin e Qendrave te Ekselencës. Nuk ka rritje te nivelit te investimeve ne kërkim dhe asnjë veprim nuk është ndërmarre për te stimuluar investimet ne kërkim dhe inovacion nga sektori privat apo për te mbështetur partneritetin midis sektorit publik dhe atij privat.

Përveç kësaj, niveli i investimeve ne kërkim si pjese e GDP-se, është i vështirë për tu përcaktuar, kjo për shkak te mungesës se statistikave te besueshme. Financimi kombëtar për kërkim nuk është rritur por sistemi është përmirësuar ne saje te një procesi te ri përzgjedhës për projektet e financuara direkt nga departamentet. Megjithatë asnjë rishqyrtim me i detajuar nuk është aplikuar deri me tani. Agjencia Shqiptare e Zhvillimit te Investimeve (AIDA), ka filluar te stimuloje zhvillimin e inovacionit prej

sipërmarrjeve duke financuar auditime teknologjike ne Sipërmarrjet e Vogla dhe te Mesme me ide inovative. Ky aksion është ne përputhje me Unionin Inovativ European.

Konkluzione

Ka progres te paket ne fushën e shkencës dhe zhvillimit. Duhet bërë përpjekje te mëtejshme ne nivel kombëtar për te forcuar kapacitetet kërkimore dhe inovative dhe për te rritur konkurrencën e vendit. Niveli i investimeve ne kërkim mbetet tepër i ulet dhe burimet njerëzore kërkojnë përforcime.

Në përgjithësi përgatitjen nuk janë avancuar shumë.

Progres Raporti 2011 për Shqipërinë

4.25. Kapitulli 25: Kërkimi dhe Shkenca

Në fushën e politikave të Kërkimit, u miratua Strategjia për Inovacionin e Biznesit dhe Transferimit të Teknologjisë për periudhën 2011 – 2016 e cila synon rritjen e kapaciteteve të SME-ve shqiptare për tu zhvilluar, për të përdorur, për të adaptuar dhe komercializuar zhvillime teknologjike, duke kontribuar në Unionin e Inovacionit. Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit (AKTI), e krijuar në vitin 2010 ka filluar punën dhe është funksionale. Niveli i investimeve në kërkim është akoma shumë i ulët (i parashikuar si 0.2% i GDP-së në vitin 2010)

Për sa i takon pjesëmarrjes së Shqipërisë në Programin e Shtatë Kuadër të Bashkimit Evropian për Kërkimin Shkencor (FP7), AKTI ka ngritur kapacitetet institucionale dhe gjithashtu ka rritur ndërgjegjësimin dhe ka shpërndarë informacione mbi pjesëmarrjen në programet e kërkimit të BE-së dhe ato ndërkombëtare. AKTI ka organizuar sesione trajnimi, work-shop-e, ditë informative mbi FP7 si dhe ka përdorur komunikimin elektronik për të shpërndarë informacion drejt palëve të interesuara.

Kapacitetet administrative janë përmirësuar me emërimin e Pikave Kombëtare të Kontaktit (PKK) dhe të deleguarve në Komitetet Menaxhuese për programin FP7. Pikat Kombëtare të Kontaktit kanë marrë pjesë në një numër aktivitete të rrjeteve përkatëse dhe në sesionet trajnuese të organizuara nga Komisioni Evropian.

Është rritur numri i aplikimeve të dorëzuara në Programin FP7, ndërsa numri i projekteve të suksesshme mbetet akoma i ulët. Shqipëria duhet të vazhdojë përpjekjet e saj për zbatimin e Memorandumit të Mirëkuptimit që Asocion Shqipërinë në Programin FP7 dhe të monitorojë nga afër pjesëmarrjen në këtë program. Përpjekje të mëtejshme kërkohen në veçanti në lidhje me ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore (Skemat Marie Curie), përfshirjen e SME-ve në kërkim dhe inovacion dhe ekselencën shkencore në përgjithësi.

AKTI është bërë anëtare e Rrjetit për Kërkim, Inovacion dhe Biznes të vendeve të Evropës Qendrore dhe Juglindore, i cili synon të inkurajojë dhe të lehtësojë bashkëpunimin midis institucioneve publike dhe private me fokus Kërkimin dhe Zhvillimin brenda dhe jashtë Bashkimit Evropian. Gjithashtu, AKTI është bërë anëtare e Shoqatës Europiane të Administratorëve të Kërkimit (EARMA). Në kuadrin e Partneriteteve Europiane për Infrastrukturat e Kërkimit, Shqipëria është në proces për të ngritur qendrën kombëtare LIFE – WATCH.

Për sa i takon integritin në Zonën Europiane të Kërkimit dhe zbatimin të Strategjisë Kombëtare për Shkencë, Teknologji dhe Inovacion (2009-2015),

procesi ka qenë i ngadaltë. Krijimi i Qendrave të Ekselencës është akoma në diskutim dhe masa të limituara janë ndërmarrë për të lehtësuar lëvizshmërinë e kërkuesve. Është përditësuar baza e të dhënave për kërkuesit Shqiptarë që punojnë brenda vendit ndërsa baza e të dhënave për kërkuesit Shqiptarë në diasporë duhet të ngrihet dhe përditësohet. Shqipëria ka emëruar të deleguarit kombëtarë në të gjitha strukturat qeverisëse të Zonës Europiane të Kërkimit, por nuk merr pjesë në mënyrë të rregullt në këto takime për mungesë të kapaciteteve administrative. Shuma e investimeve në kërkim është e vështirë të monitorohet për mungesë të statistikave reale në shkencë dhe teknologji.

Përfundimi

Në përgjithësi, Shqipëria ka bërë një punë të madhe për të rritur bashkëpunimin në fushën e kërkimit me Bashkimin Evropian dhe me palë të tjera, por nuk ka ndërmarrë masa të mjaftueshme për përforcimin e kapaciteteve të kërkimit në nivel kombëtar. Me krijimin e AKTI-t, kapacitetet administrative të nevojshme për të marrë pjesë në Programin FP7 janë përmirësuar.

Përpjekje të përbashkëta janë të nevojshme për të lehtësuar pjesëmarrjen dhe integrimin e Shqipërisë në Zonën Europiane të Kërkimit, midis të tjerave, rritja e investimeve në sektorin publik dhe privat në fushën e Kërkimit si dhe në përforcimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore. Duhet të fillohet me përgatitjet për të kontribuar në Unionin e Inovacionit.